


Lukova


Guida - Guide





Përmbajtja ► Table of Content

Lukova - Lukova	4
Si të shkoni në Lukovë - How to get to Lukova	9
Historia - History	13
Tarracat dhe aksionet - Terraces and shares	17
Fshati i vjetër - The old village	21
Arkitektura - Architecture	25
Folklori - Folklore	29
Vendet e kultit - Places of worship	33
Plazhet dhe gjiret - Beaches and bays	39
Qafa e Pazarit - Bazaar Neck	49
Kampingjet dhe Glumping - Camping and Glumping	53
Hotelet dhe bizneset e zonës - Hotels and businesses in the area	57



Lukova



Lukova është fshat bregdetar dhe fshati më jugor në krahinën e Himarës. Ndodhet direkt midis qyteteve të Himarës dhe Sarandës, konkretisht 21 km larg Sarandës.

■ Jo më shumë se 30 minuta me makinë nga secili prej këtyre qyteteve, Lukova ofron kushte shumë të favorshme për sa i përket

afërsisë me qendrat urbane, zonat e thella malore dhe detin.

■ Lukova shtrihet në Rivierën Shqiptare dhe ka rreth 3000 banorë.

Nisur nga pozicioni i saj gjeografik tipik mesdhetar, Lukova ka 300 ditë me diell në vit, laget nga deti i Jonit dhe njihet për plazhet e virgjëra.

Banorët e Lukovës quhen

lukovjotë. Etimologjia e emrit Lukovë buron nga sllavishtja “llukë”, që do të thotë: vend i gjelbëruar, pyll. Kufizohet më fshatrat Sasaj e Piqeras, Hundëcovë, Shën Vasil e Nivicë.

■ Ujërat e saj bregdetare u ofrojnë turistëve mundësinë e një eksperience të kombinuar mes plazhit dhe fshatit në një vend



të vetëm. Rrugët e saj të ngushta ruajnë karakterin e vendbanimeve origjinale mesjetare, të shtruara me kalldrëm dhe të dyja anët e rrethuara nga muret e shtëpive, të quajtura avlli.

■ Fshati shtihet në mes të tarracave me agrume në një peizazh plot kontraste mes kaltërsisë së detit Jon dhe gjelbërimit të kodrave përreth. Udhëtari francez François

Pouqueville, në fillim të shek. XIX e krahason këtë fshat me “Kopshtin e Edenit”.

■ Në vitin 1431, ekziston dëshmia e parë e shkruar e Lukovës në kadastrën osmane, fshati kishte gjithsej 44 shtëpi dhe rezultonte me emrin “Liukova”.

Në vitin 1852, Lukova kishte 340 banorë. Në vitin 1912 fshati u dogj nga osmanët dhe duke iu referuar

regjistrimeve në vitin 1913 Lukova kishte 410 banorë. Në vitin 1927, Lukova kishte 470 banorë. Në vitin 1991, regjistrimi numëronte popullsinë në 2076 banorë, por shpejt pas kësaj, pjesa më e madhe e popullsisë emigroi jashtë vendit. Më 1918 u krijua shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe. Në atë kohë, kjo ishte mjaft e rrallë për rajonin, pasi shumica e shkollave që ekzistonin drejtoheshin në greqisht.

■ Më 1983 u hap Shkolla e mesme e përgjithshme, që u bë qendër e përhapjes së kulturës dhe dijes në zonë. Më 1991 në regjistrimin e popullsisë, Lukova u popullua me banorë nga i gjithë vendi e duke qënë qendër e aksionit kombëtar të rinisë, arriti në 2076 banorë. Sot pjesa më e madhe e popullsisë ka emigruar në Greqi, Amerikë, Kanada, Itali, Gjermani etj.

Lukova



Lukova is a coastal village and the southernmost village in the province of Himara. It is located directly between the cities of Himara and Saranda, specifically 21 km from Saranda.

■ No more than 30 minutes by car from each of these cities, Lukova offers very favorable conditions in terms of proximity

to urban centers, deep mountain areas and the sea.

■ Lukova lies on the Albanian Riviera and has about 3,000 inhabitants.

Due to its typical Mediterranean geographical position, Lukova has 300 sunny days a year, is washed by the Ionian Sea and is known for its virgin beaches.

The inhabitants of Lukova are

called Lukovjots. The etymology of the name Lukovë originates from the Slavic “lukë”, which means: green place, forest. It is bordered by the villages of Sasaj and Piqeras, Hundëcovë, Saint Vasil and Nivicë.

■ Its coastal waters offer tourists the possibility of a combined beach and village experience in one place. Its narrow streets



preserve the character of the original medieval settlements, paved with cobblestones and surrounded on both sides by the walls of houses, called avlli.

■ The village is located in the middle of citrus terraces in a landscape full of contrasts between the blue of the Ionian Sea and the green of the surrounding hills. The French traveler François

Pouqueville, at the beginning of the century. XIX compares this village with the “Garden of Eden”.

■ In 1431, there is the first written evidence of Lukova in the Ottoman cadastre, the village had a total of 44 houses and resulted in the name “Liukova”.

In 1852, Lukova had 340 inhabitants. In 1912 the village was burned by the Ottomans and

referring to the censuses in 1913, Lukova had 410 inhabitants. In 1927, Lukova had 470 inhabitants. In 1991, the census counted the population at 2,076, but soon after, most of the population emigrated abroad. In 1918, a primary school was established with lessons in the Albanian language. At the time, this was quite rare for the region, as most of the schools that existed were run in Greek.

■ In 1983, the general secondary school was opened, which became the center of the spread of culture and knowledge in the area. In 1991, in the population census, Lukova was populated with residents from all over the country and being the center of the national youth action, it reached 2076 residents. Today, most of the population has emigrated to Greece, America, Canada, Italy, Germany, etc.

Si të shkoni në Lukovë





Si të shkoni në Lukovë

Lukova ndodhet në jugun e Shqipërisë, mes Himarës dhe Sarandës, jo më shumë se 30 minuta me makinë nga të dy qytetet. Mënyra më e mirë për të arritur në Lukovë nga jashtë

vendit është të fluturosh fillimisht në Korfuz dhe më pas të marrësh tragetin për në Sarandë. Nga Saranda është 25 minuta me makinë deri në Lukovë. Mund të merrni edhe çdo minibus (furgon) nga Saranda që shkon në

veri në drejtim të Himarës, Dhërmiut ose Vlorës. Ose mund të fluturoni për në Tiranë dhe të merrni autobusin për në Sarandë, që merr rrugën bregdetare dhe zbrit në qytetin e sipërm të Lukovës.

How to get to Lukova





How to get to Lukova

Lukova is located in the south of Albania, between Himara and Saranda, no more than 30 minutes by car from both cities. The best way to reach Lukova from abroad is to first fly to Corfu and then take the ferry to Saranda. From Saranda

it is 25 minutes by car to Lukova. You can also take any minibus (van) from Saranda that goes north towards Himara, Dhërmi or Vlora. Or you can fly to Tirana and take the bus to Saranda, which takes the coastal road and drops off at the upper town of Lukova.

Historia





Historia

Vendbanimi i Lukovës ndoshta daton në shekullin e njëmbëdhjetë, megjithëse terreni duket se ka qenë i banuar që nga lashtësia.

Vendndodhja e saj e hershme është qyteza e Dhoknës në kodrat e Gjashnjarit që i takon shek. III - II p.e.s.

■ Ngjarjet nuk konfirmohen, por legjenda lokale thotë se Dhokna u shkatërrua në antikitet, u dogj nga legjionet romake të gjeneralit Paulus Emilius, në vitet 167-169 p.e.s, së bashku me shtatëdhjetë qytete të tjera në Epir.

■ Banorët e Lukovës historikisht janë marrë me blegtori dhe më pak me bujqësi apo peshkim, pavarësisht nga afërsia me detin. Në mesjetën e vonë, shumë nga banorët e Lukovës migruan dhe punuan si punëtorë krahu në Francë dhe Itali. Një numër i madh shqiptarësh emigrantë nga Lukova vepronin si ushtarë në ngarkimin e Mbretërisë së Napolit, duke u dalluar për të qenë të aftë veçanërisht në pushkatim. Në betejat, thuajse të vazhdueshme kundër pushtuesve osmanë në shekullin e shtatëmbëdhjetë, Lukova, si shumë fshatra bregdetare, ishte një vatër e

përpjekjeve të rezistencës.

■ Dokumentet nga repartet e Mbretërisë së Napolit, që datojnë në shekullin e tetëmbëdhjetë shënojnë një betejë në të cilën u vranë tridhjetë banorë të Lukovës.

■ Fshati u dogj nga osmanët në vitin 1912, duke e detyruar popullsinë të shkonte në mërgim në Korfuz për gati një vit. Banorja më e famshme e Lukovës është figura legjendare Kalina. Kalina ishte një forcë kryesore gjatë rezistencës popullore të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe historia e jetës së saj është transmetuar përmes legjendave nëpër breza.

History





History

The settlement of Lukova probably dates back to the eleventh century, although the terrain appears to have been inhabited since ancient times. Its early location is the town of Dhokna in the hills of Gjashnjar which belongs to the century. III - II BC

■ The events are not confirmed, but local legend says that Dhokna was destroyed in antiquity, burned by the Roman legions of General Paulus Emilius, in 167-169 BC, along with seventy other cities in Epirus.

■ The inhabitants of Lukova have

historically dealt with livestock and less with agriculture or fishing, despite the proximity to the sea. In the late Middle Ages, many of the inhabitants of Lukova migrated and worked as manual laborers in France and Italy. A large number of Albanian immigrants from Lukova acted as soldiers in the charge of the Kingdom of Naples, being distinguished for being especially skilled in shooting. In the almost continuous battles against the Ottoman invaders in the seventeenth century, Lukova, like many coastal villages, was a hotbed of resistance efforts.

■ Documents from the wards of the Kingdom of Naples, dating from the eighteenth century, record a battle in which thirty inhabitants of Lukova were killed.

■ The village was burned by the Ottomans in 1912, forcing the population to go into exile in Corfu for almost a year. The most famous resident of Lukova is the legendary figure Kalina. Kalina was a major force during the popular resistance of the seventeenth century, and the story of her life has been passed down through legends through the generations.

Tarracat dhe aksionet





Tarracat dhe aksionet

Gjatë sistemit socialist, kur bujqësia ishte një nga sektorët kryesorë ekonomikë dhe qasja ishte "të mbështetemi në burimet tona"; përpjekjet e gjera për tarracimin e terrenit kodrinor dhe malor të Lukovës filluan që nga viti 1966 e më tej. Tarracat përbëjnë peizazhin aktual kulturor të Lukovës dhe bregdetit. Në vitin 1972, Lukova u bë qendra e Ndërmarrjes Bujqësore në Bregdet. Në sektorin e bujqësisë, Lukova ishte "Qendra e Veprimtimit Rinor Kombëtar".

■ Gjatë periudhës së kooperativës bujqësore

1957-1972 u bënë tarracimet, kanalizimet dhe objektet e ndryshme. E gjithë kjo pasuri në vitin 1972, u kthye në Fermë Shtetërore.

■ Prej vitit 1972 e në vazhdim, u shpyllëzua pjesa e mbetur e trojeve të Lukovës, të cilat fshati i shfrytëzonte për kullotë dhe për zhvillim.

■ Tradita e fshatit në bujqësi, e ngritur ndër shekuj dhe frutikultura e shumëllojshme e zgjeroi më tej shtetin në 20 vitet e fundit të sistemit komunist, ku bahçet e Lukovës në gjithë sipërfaqen, kullotat, kodrat, luginat i ktheu në një Fermë model, të njohur si

"N.B.Lukova", ku çdo kodër u shpyllëzua dhe u mboll me agrume, limona, portokalle, mandarina dhe ullishte nga banorët e fshatit. Aty numëroheshin 12 brigada me rreth 50 punëtorë secila dhe krahas tyre puna vullnetare e 800-2.000 aksionistave që vinin çdo muaj nga çdo skaj i Shqipërisë.

■ Boria e anijeve në det sinjalizonte Portin tregtar të Bunecit që shërbente për eksportin e mijëra tonë agrumeve dhe ullinjve kryesisht drejt Evropës Veriore, orën e vjeles së prodhimit, ndërsa një qendër zëri në qendër të fshatit buçiste dhe zgjonte klasën punëtore.

Terraces and shares





Terraces and shares

During the socialist system, when agriculture was one of the main economic sectors and the approach was “to rely on our own resources”; extensive efforts for the terracing of the hilly and mountainous terrain of Lukova started from 1966 onwards. The terraces make up the current cultural landscape of Lukova and the coast. In 1972, Lukova became the center of the Agricultural Enterprise on the Coast. In the agricultural sector, Lukova was the “National Youth Action Center”.

■ During the period of the agricultural

cooperative 1957-1972, terraces, sewers and various facilities were built. All this wealth in 1972, returned to the State Farm.

■ From 1972 onwards, the rest of Lukova’s land was deforested, which the village used for pasture and development.

■ The tradition of the village in agriculture, built up over the centuries and the diverse fruit culture further expanded the state in the last 20 years of the communist system, where Lukova’s gardens on the entire surface, pastures, hills, valleys turned into a model farm, known like “NB Lukova”, where every hill was deforested

and planted with citrus fruits, lemons, oranges, tangerines and olive trees by the villagers. There were 12 brigades with about 50 workers each and alongside them the voluntary work of 800-2,000 shareholders who came every month from all over Albania.

■ The horn of the ships at sea signaled the commercial port of Bunec, which served for the export of thousands of tons of citrus fruits and olives mainly to Northern Europe, the time of the production harvest, while a sound center in the center of the village blared and woke up the working class.

Fshati i vjetër





Fshati i vjetër

Fshati i vjetër i Lukovës është stil tipik mesdhetar dhe është vendi ku jetojnë banorët më të hershëm të Lukovës. Me rrugicat e ngushta dhe të kalldrëmta, shtëpitë e vjetra karakteristike me dyert shumëngjyrëshe dhe të mbuluara me disa lloje lulesh, ky fshat duket sikur të transporton në një përrallë. Aromat dehëse të luleve shoqërohen

me cicërimat e dallëndysheve, që fluturojnë paqësisht mbi të gjithë Lukovën. Pothuajse në çdo rrugicë sheh kanalet e ujit majtas dhe djathtas rrugës. Aty nuk mund të futen makina. Në shtëpitë e vjetra mund të shihen portat e oborreve me harqet e gurta, ndersa shkrimet dhe figurat e skalitura në to tregojnë trashëgiminë kulturore që mbartin ndër vite. Aty janë xhiruar mbi 20 filma dhe 10 videoklipe.

The old village

The old village of Lukova is typical Mediterranean style and is the place where the earliest inhabitants of Lukova live. With narrow and cobbled streets, characteristic old houses with colorful doors and covered with several types of flowers, this village seems to transport you to a fairy tale. The intoxicating aromas of flowers are accompanied

by the chirping of swallows, flying peacefully over Lukova. In almost every alley you see water channels left and right on the road. Cars cannot enter there. In old houses can be seen the gates of the courtyards with the stone arches, while the writings and figures carved in them show the cultural heritage they carry over the years. Over 20 films and 10 video clips were shot there.



The old village



Arkitektura





Arkitektura

Shtëpitë e Lukovës janë ndërtuar me gurë lokalë. Pothuajse pas çdo shtëpie ka pemishte dhe vreshta. Shtëpitë e vjetra në Lukovë kanë ruajtur cisterna në tokë, që dikur furnizoheshin nga uji i shiut. Këto cisterna në katet përdhese kanë shërbyer historikisht si një vend ku mund të ruhej edhe ushqimi, për shkak të temperaturave të qëndrueshme dhe më të ftohta. Shtigjet e vogla të krijuara nga njeriu dhe kafshët përshkojnë kodrën

në të cilën është ndërtuar fshati, që të çojnë nga rruga kryesore, përmes terracave bujqësore deri në breg të detit. Fshati shtrihet mbi dy kodra të mbuluara me plantacione ulliri dhe portokalli në një lartësi prej 150 metrash mbi nivelin e detit. Bërthama e këtij fshati shquhet për integritetin e lartë të ruajtjes së arkitekturës tradicionale të ndërtimit, me banesa dy deri tre katëshe, si dhe portat e tyre me qemer dhe qoshet e gdhendura me simbole tradicionale të bestytisë popullore të zonës.

Architecture

The houses of Lukova are built with local stones. Almost every house has orchards and vineyards. The old houses in Lukova have preserved cisterns in the ground, which were once supplied by rainwater. These cisterns on the ground floors have historically served as a place where food could also be stored, due to the stable and cooler temperatures. Small man-made and animal paths criss-cross the hill on which the village is built,

leading from the main road through the agricultural terraces to the seashore. The village lies on two hills covered with olive and orange plantations at an altitude of 150 meters above sea level. The core of this village stands out for the high integrity of the preservation of the traditional building architecture, with two to three-story dwellings, as well as their vaulted gates and corners carved with traditional symbols of the popular superstition of the area.



Architecture



Folklori





Folklori

Deri në fillim të shekullit të njëzetë, burrat në Lukovë vishnin fustanellën - një pëlhurë e qepur nga endja në tezgjah, duke përdorur fije leshi ose liri të hollë. Fustanella qepej në ngjyrë të bardhë, pantallona që ndalonin pak poshtë gjurit. Poshtë, burrat mbanin një tirq të bardhë, ose pantallona të gjata, të lidhura me gërsheta me xhufka. Në krye, burrat mbanin jelek bardh e zi dhe një kapele tradicionale të kuqe me një xhufkë të verdhë. Veshja e tyre shoqërohej me këpucë tradicionale mokasine

lëkure, kryesisht të kuqe me thekë të zeza sipër. Nën jelek, burri kishte këmisha me mëngë të gjera, të punuara në pëlhurë të bardhë kambrik ose të importuar. Në mes, në vendin ku bashkohej jeleku, mbështillej një brez i gjatë, i punuar me fije liri, kryesisht me ngjyrë të kuqe dhe rrallë kafe. Ky brez ishte rreth dy metra e gjysmë i gjatë dhe i gjerë sa pëllëmba e dorës. ■ Veshja tradicionale femërore njihet si veshta—një robë e mbështjellë, fundi i së cilës është zbukuruar me një shirit të punuar me grep me ngjyra të pasura. Në vend të veshtës, gratë

e moshuara mbanin një copë të gjatë e të gjerë, me ngjyrë të errët. Në Labëri, fustani do të shoqërohej me një triko të thurur.

■ Ngjyrat korrespondojnë me moshën e gruas (e kuqe për vajzat e reja, errësuar me kalimin e moshës). "Kënga e Lukovës", e ngjashme me shumë fshatra të tjerë në jug është polifonia e harmonizuar e zërave të ndryshëm në një linjë të vetme melodike. Përveç kësaj, këngët e dasmave dhe funeraleve paraqesin interes për studiuesit për shkak të pranisë së elementeve pagane në to.

Folklore





Folklore

Until the beginning of the twentieth century, men in Lukova wore a fustanella - a fabric sewn by weaving on a loom, using wool or fine linen threads. The dress was sewn in white, pants that stopped just below the knee. Below, the men wore a white tirza, or long trousers, tied with braids and tassels. On top, the men wore a black and white waistcoat and a traditional red hat with a yellow tassel. Their attire was accompanied by traditional leather moccasin shoes,

mostly red with black fringe on top. Under the waistcoat, the men wore shirts with wide sleeves, made of white cambric or imported cloth. In the middle, where the waistcoat joined, a long belt was wrapped, made of linen thread, mostly red and rarely brown. This belt was about two and a half meters long and as wide as the palm of the hand. ■ Traditional women's clothing is known as the veshta—a wrap-around garment, the bottom of which is decorated with a richly colored crocheted ribbon. Instead of a vest,

older women wore a long, wide, dark-colored piece. In Labëri, the dress would be accompanied by a knitted sweater.

■ The colors corresponded to the age of the woman (red for young girls, darkened with age). The “Song of Lukova”, similar to many other villages in the south, is the harmonized polyphony of different voices in a single melodic line. In addition, wedding and funeral songs are of interest to researchers due to the presence of pagan elements in them.

Vendet e kultit





Vendet e kultit

Ka dëshmi se një shenjtor i kishës së krishterë ortodokse, Oshenar Nifoni, ka lindur në Lukovë diku gjatë shekullit të trembëdhjetë.

Fillimisht punoi si prift në manastirin e Mesopotamisë, ndërsa më vonë arriti gradën më të lartë të Patriarkut Ekumenik në Kostandinopojë në 1310, dhe u shenjtërua pas vdekjes së tij.

■ Kisha e Shën Kollit, emër i marrë nga Shën Nifoni ndodhet gjatë rrugës që të nxjerr te rruga nacionale, është një kishë e

vogël, e aksesueshme lehtë nga turistët.

■ Disa metra larg qendrës së fshatit ndodhet Kisha Shën e Premte, Monument Kulture i kategorisë së parë (I).

■ Kisha daton prej vitit 1600 dhe ndodhet në një kodrë me pamje nga deti Jon. Dikur kisha Shën e Premte kishte një kabanë, e cila ishte dhuruar nga mbreti i Napolit në vitin 1695, por u zhdruk në vitin 1967, gjatë shkatërrimit masiv të kishave dhe xhamive që u bënë nën regjimin e Enver Hoxhës.

■ Kisha e Shën Thanasit ndodhet në fshatin Lukovë, 22 m larg fushës së sportit dhe 223 m larg rrugës kombëtare. Athanasius I i Aleksandrisë (296-292 – 2 maj 373), i quajtur ndryshe Athanasius i Madh, ishte një "baba" i kishës greke dhe Papa i 20-të i Aleksandrisë. Episkopata e tij zgjati 45 vjet. Ai ishte një teolog i krishterë, themelues i kishës, mbrojtës i Trinitarizmit dhe një udhëheqës i Krishterimit në Egje gjatë shekullit të katërt.



+

SHENKOLL
ΑΓΙΟΣ ΝΙΚΟΛΑΟΣ

Vendet e kultit



Places of worship





Places of worship

There is evidence that a saint of the Orthodox Christian Church, Oshenar Nifoni, was born in Lukovo sometime during the thirteenth century. He first worked as a priest in a monastery in Mesopotamia, and later reached the highest rank of Ecumenical Patriarch in Constantinople in 1310, and was canonized after his death.

■ The Church of Saint Kolli, named after Saint Nifoni, is located on the way to the national road, it is a small church, easily

accessible by tourists.

■ A few meters away from the center of the village is Saint Friday Church, Cultural Monument of the first category (I). The church dates back to 1600 and is located on a hill overlooking the Ionian Sea.

■ Once the Saint Friday church had a bell, which was donated by the king of Naples in 1695, but it disappeared in 1967, during the massive destruction of churches and mosques that took place under Enver Hoxha's regime.

■ The Church of Saint Thanasi is located in the village of Lukovë, 22 m from the sports field and 223 m from the national road. Athanasius I of Alexandria (296-292 – 2 May 373), also called Athanasius the Great, was a “father” of the Greek church and the 20th Pope of Alexandria. His episcopate lasted 45 years. He was a Christian theologian, church founder, defender of Trinitarianism, and a leader of Christianity in the Aegean during the fourth century.



Places of worship





Plazhet dhe gjiret

Fshati Lukovë nuk është i lidhur fizikisht me plazhin, por deti nuk është larg. Lukova në bregdetin e saj të gjerë strehon një numër të madh plazhesh të përmasave të ndryshme, duke filluar që nga plazhet e vogla me një atmosfere tejet intime deri tek plazhet popullore.

■ Pasi të jeni në rrugën nacionale që kalon përmes Lukovës, do të gjeni shenja të

plazhit: “Plazhi i Shpellave” të Lukovës dhe “Plazhi i Bunecit” i njohur nga pushuesit.

■ Plazhi i Shpellës Lukovë gjendet 25 km larg Sarandës. Plazhi pranë saj, ka emrin e shpellës së Lukovës.

■ Rruga për në “Plazhin e Shpellave” ndjek kodrat poshtë si një rrugë gjarpëruese midis ullinjve.

■ Plazhi i Bunecit shtrihet mes Borshit e Lukovës, i vendosur në dy krahët e përroit

të Lapardhasë.

Ai ka formën e harkut, me një gjatësi të vijës së bregut 2000 m dhe në dy krahët e pistës së betonit ankoroheshin dikur anijet ushtarake, ndërsa tani varkat e peshkatarëve.

■ Në Lukovë mund të gjeni disa plazhe private si Matias Fish dhe La onda, dy plazhet më të frekuentuara, Beach Bar dhe Restorant.

Plazhet dhe gjiret





■ Ju mund të merrni me qira shtretër plazhi dhe çadra nëse dëshironi, por gjithashtu mund të vendosni peshqirët e plazhit buzë detit për të marrë disa rreze dhe për të shijuar natyrën.

■ Gjiri i Barklesë dhe gjiret e tjerë të fshehur të bregdetit ofrojnë pamje

mahnitëse që të lënë pa frymë të plazheve të virgjëra në Lukovë, të paprekura nga dora e njeriut. Për t'i parë rekomandohet ecja disa minuta në këmbë.

■ Lumra ndodhet në bregdetin e virgjër të Lukovës, aty ku mali puthet me detin dhe guralecët e bardhë. Rruga dhe

shtigjet përmes ullishteve të çojnë në gjiret e fshehura natyraliste poshtë në breg. Në këtë zonë ndodhen disa prej kampingjeve më të njohura.

■ Mrostartari përfshin ish-rrugën e vjetër të agrumeve në kohën e brezareve para viteve '90, shtigjet dhe rrugën që të çon te "Plazhi i Shpellës".

Beaches and bays





Beaches and bays

The village of Lukovë is not physically connected to the beach, but the sea is not far away. Lukova on its wide coast hosts a large number of beaches of different sizes, starting from small beaches with a very intimate atmosphere to popular beaches.

■ Once you are on the national road that passes through Lukova, you will find signs

of the beach: “Cave Beach” of Lukova and “Buneci Beach” known by vacationers.

■ Lukovë Cave Beach is located 25 km from Saranda. The beach next to it is named after the Lukova cave.

The road to “Cave Beach” follows the hills below as a winding road between olive trees.

■ Bunec Beach lies between Borsh and Lukova, located on both sides of the

Lapardha stream.

■ It has the shape of an arch, with a coastline length of 2000 m, and on the two sides of the concrete runway, military ships were once anchored, while now fishing boats were anchored.

■ In Lukova you can find several private beaches such as Matias Fish and La onda, the two most frequented beaches, Beach Bar and Restaurant.

Beaches and bays





■ You can rent beach beds and umbrellas if you want, but you can also lay out your beach towels by the sea to catch some rays and enjoy nature.

■ Barkle Bay and other hidden bays of the coast offer breathtaking views of the virgin beaches in Lukovo, untouched

by human hands. To see them, it is recommended to walk a few minutes.

■ Lumra is located on the virgin coast of Lukova, where the mountain kisses the sea and the white pebbles. The road and paths through the olive groves lead to hidden naturalist coves down

on the coast. Some of the most popular campsites are located in this area.

■ Mrostari includes the old citrus road in the time of the generations before the 90s, the paths and the road that leads to the “Cave Beach”.



Beaches and bays



Qafa e Pazarit





Qafa e Pazarit

Gjurmë të një kalaje të vjetër që besohet të jetë e shekullit III-II-të para Krishtit janë gjetur edhe në vendin që fshatarët e quajnë “Qafa e Pazarit”.

- Aty gjenden mbetjet e qytetit epik të ës, ndërtim që daton 2000 vjet më parë nga popullsitë e fisit të kaonëve. Qafa e Pazarit ka shërbyer si qendër tregtare midis Himarës, Korfuzit, Delvinës dhe Gjirokastrës.
- Aktualisht mund të shihen vetëm

disa mure antike. Mbetje të tjera të vogla të qytetit antik mund të shihen të shpërndara midis kodrave të Lukovës. Gjithashtu gjenden edhe varret antike shek. V-IV p.e.s. “Varret e Jelimëve”, 2.5 km larg qendrës së fshatit në rrugën e “Plazhit të Shpellës”, në vendin e quajtur “Kala”.

- Nëse ecni rrugëve të fshatit mund të zbuloni ujësjellësin e vjetër, që tashmë shërben si një burim nga mali me ujë të ftohtë dhe bunkerët e periudhës së komunizmit.

Bazaar Neck

Taces of an old castle believed to be from the 3rd-2nd century BC have also been found in the place that the villagers call “Bazaar Neck”.

- There are the remains of the epic city of Dhokna, a construction dating back 2000 years ago by the Kaon tribe population. Qafa e Pazar has served as a commercial center between Himara, Corfu, Delvina and Gjirokastra.
- Currently, only a few ancient walls can be seen. Other small remains of

the ancient city can be seen scattered among the hills of Lukova. There are also ancient tombs c. V-IV BC “Varret e Jelimëve”, 2.5 km from the center of the village on the road to “Cave Beach”, in the place called “Kala”.

- If you walk the streets of the village you can discover the old aqueduct, which now serves as a spring from the mountain with cold water, and bunkers from the communist period.

Kampingjet dhe Glumping





Kampingjet dhe Glumping

Turistët që mbushin fshatin muajt e verës, janë natyralistë. Kamperat dhe çadrat përhapen nëpër ullinj të shumtë që bashkohen në harmoni të plotë me ngjyrën e kaltër të detit Jon.

■ “Gate to Horizon”, e ka marrë emrin për shkak të bukurisë natyrore që e rrethon. Perëndimet e diellit dhe një pamje e mrekullueshme e horizontit i dhanë emrin këtij vendi.

■ “Llaka e Bredhanit” quhet zona poshtë plazhit, pjesë e fshatit Lukovë ku ndodhet kampingu, në bregun e Lumrës. Është një plantacion me ullinj

të vjetër dhe agrume të ndryshme që ofron shumë hije dhe freski gjatë ditëve të nxehta të verës.

Është një vend për pushimet aventureske dhe adhuresve të natyrës.

■ Vendi i kampingut konsiderohet si një vend i qetë, i rrethuar nga natyra. Gjithashtu ka aktivitete në kamping si hiking, zhytje, surfing me erë etj.

■ Turistët ngrenë çadrën e vet dhe mund të përdorin lehtësisht ambientet e kampingut. Ka një skarë për t’u përdorur për këdo që kënaqet me BBQ. Kryesisht turistët e huaj marrin me vete

dhe automjetet e posaçme rulotë ose kampera për kamping.

■ Në kamp mund të gjeni produkte Bio nga fshati si dhe vaj ulliri Bio nga ulliri dhe agrumet që ndodhen aty. Restoranti ofron shije të mrekullueshme të produkteve të freskëta të detit Jon.

■ Përveç tij gjenden edhe disa kampingje të tjera që frekuentohen kryesisht nga të huajt. Aktualisht është duke u përgatitur edhe një glumping i ri, ku do të ndërthuret elementi natyralist me modernen.

Camping and Glamping





Camping and Glumping

The tourists who fill the village in the summer months are naturalists. Campsites and tents spread among the many olive trees that blend in perfect harmony with the blue color of the Ionian Sea.

■ “Gate to Horizon”, got its name because of the natural beauty that surrounds it. Sunsets and a wonderful view of the horizon gave this place its name.

■ “Llaka e Bredhanit” is the name of the area below the beach, part of the village of Lukovë

where the campsite is located, on the shore of Lumra. It is a plantation with old olive trees and various citrus fruits that offers a lot of shade and freshness during hot summer days. It is a place for adventure vacations and nature lovers.

■ The campsite is considered a quiet place, surrounded by nature. There are also camping activities such as hiking, diving, windsurfing, etc.

■ Tourists pitch their own tent and can easily use the camping facilities. There is a grill to use for anyone who enjoys BBQ. Mostly

foreign tourists take with them special vehicles, caravans or campers for camping.

■ In the camp you can find Bio products from the village as well as Bio olive oil from the olives and citrus fruits located there. The restaurant offers wonderful tastes of fresh Ionian sea products.

■ In addition to it, there are also several other campsites that are mainly frequented by foreigners. Currently, a new glumping is being prepared, where the naturalist element will be combined with the modern one.

Hotelet dhe bizneset e zonës





Hotelet dhe bizneset e zonës

Në Lukovë gjenden hotele dhe dhoma pushuesish për të gjithë vizitorët që duan të kalojnë disa ditë në perlën e Rivierës Shqiptare. Ndër to po rendisim:

1. **Hotel Itaka.** Mes gjelbërimit dhe me një pamje mahnitëse nga deti, krahas dhomave dhe vilave private me mure guri, ofron një tarracë, një bar, restorant, pishinë të jashtme, ajër të kondicionuar falas dhe parkim falas privat. Me një mjedis shumë miqësor ku ndërthuret tradicionalja me

modernen, Hotel Itaka ofron një opsion perfekt për ata që duan qëndrim komod dhe facilitete. Pronari i këtij hoteli, Z. Odise Papa thotë se “Gjelbërimi dhe bregdeti në Lukovë janë në harmoni të plotë. Perëndimi i diellit është një premierë që shfaqet çdo mbrëmje në horizont”, ndërsa mendon se vitet e fundit turizmi bregdetar në jug të vendit ka ndryshuar mënyrën e shërbimit ndaj pushuesve në sensin pozitiv.

2. **Apartmentet Eduart Lagji** kanë pamje mahnitëse nga deti ose nga koshti plot me

gjelbërim, agrume dhe lule. Ka WiFi falas dhe parkim privat falas. Ndodhet 2.5 km nga plazhi i Lukovës. Çdo njësi ka një aneks kuzhine, ajër të kondicionuar, një TV me ekran të sheshtë dhe një banjo private me tharëse flokësh, ballkon dhe gardërobë.

3. **Hotel Vila Kafe.** I vendosur në Lukovë, 2.8 km nga plazhi i Bunecit, Hotel Vila Kafe ofron akomodim me një pishinë të jashtme sezonale, parkim privat falas, një kopsht dhe një sallë pritjeje të përbashkët. Hoteli ka një tarracë dhe një bar. Në hotel, dhomat

Hotelet dhe bizneset e zonës





kanë një ballkon. Çdo dhomë është e pajisur me ajër të kondicionuar dhe një TV me ekran të sheshtë, dhe disa njësi në Hotel Vila Kafe kanë pamje nga deti.

■ Në Lukovë ka disa restorante që shërbejnë ushqim të shijshëm mesdhetar. Sugjerohen disa pika ku mund të konsumohet ushqim i cilësisë së lartë: Një prej tyre është restorant Perla në hyrje të fshatit, ku supa, sallata dhe gatimet e peshkut nga zonja e shtëpisë janë të mrekullueshme.

■ Restorant Panorama, krahas ushqimit dhe pijeve cilësore ofron një pamje mahnitëse mbi det, ashu siç ka dhe emrin.

■ Për të dashuruarit pas brumit dhe picës, Lukova ofron një nga piceritë më surprizuese të Rivierës shqiptare. Piceri Riviera Lukovë, një ballkon mbi det, në një kënd të vogël të rrugës kryesore që shkon përmes fshatit, do t'ju befasojë.

■ Kjo piceri e vogël, në mbrëmje është e mbushur me turistë të huaj, kryesisht gjermanë e zviceranë, edhe pse është ende

fillim qershori.

■ Një tjetër piceri gjatë rrugës kryesore në fshat quhet Piceri Era dhe ofron pica të shijshme në furrë druri. Gjithashtu ofron transport në çdo zonë të plazhit apo fshatit.

■ Lukova është një vend i mrekullueshëm për t'u çlodhur dhe për të shijuar natyrën, gjithashtu mund të shijoni edhe bukuritë e fshatit me dyqane, kafene dhe restorante. Përveç plazheve, ambienti është i mrekullueshëm edhe për shëtitje ose kalërim.

Hotels and businesses in the area





Hotels and businesses in the area

In Lukovë, there are hotels and guest rooms for all visitors who want to spend a few days in the pearl of the Albanian Riviera. Among them we are listing:

1. Hotel Itaka. Among the greenery and with a stunning view of the sea, in addition to private rooms and villas with stone walls, it offers a terrace, a bar, restaurant, outdoor pool, free air conditioning and free private parking. With a very friendly environment where the traditional meets the modern, Hotel

Itaka offers a perfect option for those who want a comfortable stay and facilities. The owner of this hotel, Mr. Odise Papa, says that “Greenery and the coast in Lukova are in complete harmony. The sunset is a premiere that appears every evening on the horizon”, while he thinks that in recent years coastal tourism in the south of the country has changed the way of serving vacationers in a positive sense.

2. Eduart Lagji apartments have stunning views of the sea or the garden full of

greenery, citrus fruits and flowers. There is free WiFi and free private parking. It is located 2.5 km from Lukova beach. Each unit has a kitchenette, air conditioning, a flat-screen TV and a private bathroom with a hairdryer, a balcony and a wardrobe.

3. Hotel Vila Kafe. Located in Lukovë, 2.8 km from Bunec Beach, Hotel Vila Kafe provides accommodation with a seasonal outdoor swimming pool, free private parking, a garden and a shared lounge.

Hotels and businesses in the area





The hotel has a terrace and a bar. At the hotel, the rooms have a balcony. Each room is equipped with air conditioning and a flat-screen TV, and some units at Hotel Vila Kafe have a sea view.

- In Lukovo there are several restaurants that serve delicious Mediterranean food. Some places where you can eat high quality food are suggested: One of them is Perla restaurant at the entrance of the village, where the soup, salad and fish dishes of the

lady of the house are wonderful.

- Panorama Restaurant, in addition to quality food and drinks, offers a stunning view over the sea, just like its name.
- For dough and pizza lovers, Lukova offers one of the most surprising pizzerias of the Albanian Riviera. Pizzeria Riviera Lukovë, a balcony over the sea, in a small corner of the main road that goes through the village, will surprise you.
- This small pizzeria is full of foreign tourists in the evening, mainly German and

Swiss, even though it is still early June.

- Another pizzeria along the main road in the village is called Pizzeria Era and offers delicious wood-fired pizzas. It also offers transportation to any beach or village area.
- Lukova is a great place to relax and enjoy nature, you can also enjoy the beauty of the countryside with shops, cafes and restaurants. In addition to the beaches, the environment is also great for hiking or horse riding.

